



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1957, datë 24.05.2012

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1882, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.05.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1882, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.”,

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);
- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);
- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Rregullore Nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD nr. 1774, datë 02. 02. 2012.
6. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 1882, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.”,
- Shkresa e Neofone sh.p.k. me nr. 154Prot. datë 3.5.2012, ka depozituar “*Parashtrime përfundimtare për VKD nr. 1882, datë 19.4.2012*”,
- Shkresa e Vodafone Albania sh.a., me ref. LGD/0142/0X, datë 4.5.2012, (nr. 509/5Prot. i AKEP, datë 7.5.2012) “*Dërgohen shpjegimet e Vodafone Albania për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone dhe Vodafone Albania, të filluar me VKD nr. 1882, datë 19.4.2012*”;
- Korrespondenca e shkëmbyer me postë elektronike mes palëve, si edhe
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 1882, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

- “Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.;
- Të njoftohen palët e interesuara sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;
- Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;

II. Në zbatim të vendimit të lartpërmendur, sipërmarrësi Neofone sh.p.k. me shkresën nr. 154Prot. datë 3.5.2012, ka depozituar “*Parashtrime përfundimtare për VKD nr. 1882, datë 19.4.2012*”, dhe sqaron se:

1. Mosmarrëveshja e Neofone sh.p.k. me Vodafone, ka filluar me shkresën ref. CEO/016/EXH, datë 7.2.2012, dërguar nga Vodafone, ku i njoftonte Neofone sh.p.k. ndryshime të njëanshme të tarifës së interkoneksionit për thirrjet me origjinë ndërkombëtare drejt rrjetit të Vodafone;
2. Në përgjigje Neofone dërgon shkresën nr. 129Prot., datë 8.2.2012, “*Përgjigje shkresës së Vodafone me ref. CEO/016/EXH datë 7.2.2012*” ku e sqaron se është në dijeni të VKD nr. 1740, datë 20.12.2012, dhe shpreh gadishmërinë dhe vullnetin për zbatimin rigoroz të tij dhe realizimin e negociatave dypalëshe. Shkresa e Vodafone ref. CEO/016/EXH, datë 7.2.2012, drejtuar Neofone nuk është në përputhje me VKD nr. 1740, datë 20.12.2012, pasi Vodafone sugjeron vendosjen në mënyrë të njëanshme të tarifës së terminimit, me metoda detyruese – përcaktuese. AKEP nuk shprehet asgjekundi që operatori FNT Vodafone ka të drejtën e vendosjes së tarifës. Në të kundërt AKEP do që shprehur në mënyrë eksplicite: *Tarifa e terminimit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare vendoset nga Vodafone*. Sa më sipër Neofone mbetet në pritje të një takimi dypalësh me qëllim realizimin e negociatave për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe modalitete të tjera të marrëdhënies, në zbatim të VKD nr. 1740.
3. Në vijim mes palëve më datë 9.2.2012, u zhvillua një takim, në përfundim të të cilit palët nuk ranë dakord për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone. Vodafone nuk ka pranuar të negociojë tarifën e propozuar me shkresën me ref. CEO/016/EXH dhe Neofone nuk ka firmosur amendamentin e marrëveshjes së interkoneksionit. Tarifa e paraqitur nga Vodafone është 17.5 lekë/min, vlerë e cila është sa dyfishi i tarifës së mëparshme prej 7.57 lekë/min dhe gati katërfishi i kostos reale të Vodafone përcaktuar nga BULRAIC (prej 4.6 lekë/min).
4. Më datë 15.2.2012, Vodafone në kundërvajtje me cdo klauzolë të kuadrit rregullator, pa njoftim e në mënyrë të njëanshme ka anuluar 20 kanale (CIC) të kapacitetit minimal 2Mbit/s në shërbim të Neofone. Ndërsa me datë 24, shurt ka bllokuar edhe 9, kanale tjetër. Aktualisht qëndron i hapur vetëm një kanal. Vodafone ka shkelur aneksin 4, pikën 4.6.5, kapacitet minimal.

5. Në përgjigje të kësaj shkeljeje, me anë të postës elektronike Neofone, po më datë 15.2.2012, ka njoftuar Vodafone për anulimin e faciliteteve shoqëruese dhe ndërprerjen e aksesit për shërbimet e përfshira në MI mes palëve.
6. Më 17.2.2012, me anë të postës elektronike Vodafone i është përgjigjur duke pranuar anulimin, me motivacionin se *“Neofone ka refuzuar shërbimin e trafikut ndërkombëtar në rrjetin e Vodafone”*;
7. Me shkresën nr. 135Prot., datë 20.2.2012, *“Për anulimin e faciliteteve shoqëruese të alokuara Neofone dhe ndërprerjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve me origjinë ndërkombëtare”* drejtuar Vodafone, ka shpjeguar se, Neofone pasi i është njoftuar tarifa prej 17.5 lekë/min, e ka kundërshtuar këtë tarifë abuzuese, si:
 - Cmimi nuk është i orientuar drejt kostos, madje e tejkalon koston disa herë, duke krijuar një përqindje disa herë fitimi, si dhe duke krijuar një monopol të Vodafone;
 - Diskriminon llojin e trafikut në lidhje me origjinën kombëtare/ndërkombëtare;
 - Është tarifë më e lartë se kufiri maksimal i tarifave të rregulluara nga AKEP;
 - Eshtë disa herë më e lartë se cmimet mesatare të zbatuara në BE;
 - Është cmim abuzues, shpërdorues dhe antikonkurrues, pasi është mjaftueshëm i lartë për të nxjerrë nga tregu operatorët e tjerë.

Neofone sqaron se Vodafone po keqinterpretonte qëllimisht VKD nr. 1740, me qëllim final dëmtimin e konkurrencës së lirë në tregjet e shumicës për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare.

Bazuar në ligjin për konkurrencën, neni 19 *“Abuzimi me pozitën dominuese”*, njoftimi i tarifës më shumë se dy herë më të lartë se kosto nga Vodafone, përbën fakt të pajustificueshëm të përdorimit të pozitës dominuese në treg duke vërtetuar sjelljen monopolistike, në dëmtim të konkurrencës së lire dhe shkelje të ligjit nr. 9918.

Në përfundim, Neofone e fton Vodafone të riparojë urgjentisht hapat antiligjore në dëm të tij, duke kthyer facilitetet shoqëruese për normalizimin e marrëdhënies dypalëshe, duke zbatuar detyrimet si FNT, përpara datës 25.2.2012, në të kundërt Neofone do të fillojë procedimet ligjore.

8. Vodafone kthen përgjigje Neofone, me shkresën ref. LDG/033/OX, datë 24.2.2012, dhe bën me dije se:

Vodafone po zbaton me përpikmëri kuadrin ligjor dhe implementimin e VKD nr. 1740, për regjimin e ri të trafikut ndërkombëtar.

Vodafone, sqaron se aksesi në facilitet nuk është penguar për asnjë moment. Kapaciteti që Neofone ka në dispozicion është konfiguruar për të plotësuar maksimalisht nevojat e tij, për shërbimet që ka pranuar të shfrytëzojë dhe për të cilat është rënë dakord mes palëve paraprakisht.

Përlllogaritja është mbështetur në dispozitat e ORI të Vodafone, dhe MI në fuqi mes palëve, në pëputhje të plotë me parashikimin që Neofone ka depozituar në momentin e lidhjes së MI dhe në funksion të trafikut që disponon departamenti i Vodafone për 6 muajt e fundit të utilizimit nga ana juaj. Çdo pretendim i ngritur nga ana juaj në këtë drejtim është plotësisht i pabazuar në ligj.

Vodafone sqaron se, Neofone është shprehur qartë përmes shkresave dhe postës elektronike, dhe në takimin e dt. 9.2.2012, se nuk pranon tarifën e njoftuar nga Vodafone. Bazuar në Kodin Civil të RSH, neni 663, për sa kohë Neofone nuk pranon tarifën e shërbimit, shërbimi specifik nuk mund të ofrohet.

Vodafone, në lidhje me pretendimet e Neofone se tarifa e njoftuar nga Vodafone nuk ka qenë subjekt negociatash dhe se AKEP me VKD nr. 1740, nuk shprehet asgjëkundi se Vodafone ka të drejtën e vendosjes së tarifës së terminimit sqaron se: këtë çështje e ka sqaruar plotësisht ligji nr. 9918, se tarifa është diskrecion të palës që ofron shërbimin neni 53/1. Në të njëjtën mënyrë veprojnë edhe operatorët alternativë si Neofone kur përcaktojnë çmimin e terminimit në rrjetin e tyre. Çdo pretendim, në këtë drejtim është i pabazë dhe në mosnjohje të ligjit.

Vodafone, sqaron se nuk ekziston anjë ligj apo akt nënligjor mbi përkufizimin e procesit të negociimit, ndaj dhe negociatat për vetë natyrën mbeten një koncept shumë i gjerë dhe fleksibël, si në kuptim ligjor ashtu edhe komercial. Në këtë kuadër Vodafone ka ndjekur një praktikë gjerësisht të njohur e të pranuar në tregun ndërkombëtar të telekomunikacioneve, atë të njoftimit të çmimit me nje afat implementimi 7 ditor.

Sa i takon, përdorimit të pozitës dominuese të Vodafone, me një sjellje monopolistike (citur) duke dëmtuar konkurrencën në treg, Vodafone ju ri-konfirmon që në asnjë moment nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në treg. Përkundrazi e ka njoftuar tarifën e terminimit të të gjithë operatorët, pa diskriminuar asnjë prej tyre.

Sa i takon tarifave të parregulluara, si tarifa e terminimit të trafikut ndërkombëtar, ato janë objekt i “forcave” natyrale të tregut të lirë, ofertë – kërkesë, dhe absorbimi i tarifës ndjek të njëjtin proces si ndodh në tregjet europiane konkurruese.

Bazuar në ligjin nr. 9123 dhe ligjin nr. 9918, por edhe jursiprudencës ndërkombëtare Vodafone nuk ka mbajtur e nuk mban status monopolistik në treg, ndaj dhe nuk mund të sillët si e tillë si ju në mosnjohje të ligjit shpreheni. Sa më lart ritheksojme se Vodafone, ka zbatuar me përpikmëri parimin e mosdiskriminimit (ligji nr. 9918) dhe nuk ka abuzuar me pozitën dominante (ligji nr. 9123).

Vodafone shprehet se kapacitet alokohen në varësi të të parashikimit të paraqitur nga palët, sipas ORI të vodafone dhe MI e lidhur mes palëve (aneksi IV), dhe çdo përpjekje e qëllimshme e bërë nga Neofone për të ngritur dyshime e konfuzion është tërësisht e pabazë.

Sa i takon deklarimit të Neofone se operon me pajtimtarë biznes dhe aplikon një model biznes carrier dhe bartës i trafikut ndërkombëtar (*cituar nga email i dt. 17.2.2012*), ju kujtojmë se nëse kjo është materializuar, do të përbënte shkelje të kushteve të marrëveshjes mes palëve. Terminimi i thirrjeve kombëtare të tranzituara nga Neofone, pa miratim paraprak në formë të shkruar mes palëve Neofone – Vodafone është në kundërshtim të hapur MI në fuqi (aneksi V). Vodafone gjen rastin t'i komunikojë Neofone, se në mungesë të nënshkrimit të amendimit përkatës së MI, çdo veprim i ndërmarrë në kundërshti sa më lart përbën shkelje të MI, neni 20, dhe Vodafone do të ndërmarrë të gjithë hapat ligjorë për të rivendosur në vend të drejtën e saj.

9. Neofone sqaron se pas kësaj korrespondence, nga Vodafone nuk ka patur reagim tjetër, dhe Vodafone vazhdon të mbajë të mbyllur qarqet e interkoneksionit me kapacitet minimal 2Mbit/s, duke lënë vetëm një kanal të hapur.
10. Në kontekstin tregtar Neofone, ka marrëveshje me palë të treta për mundësimin e terminimit të trafikut në rrjetin e Vodafone, si dhe përmbush misionin e krijimit të konkurrencës efektive në tregun shqiptar, për të cilin Vodafone mban statusin FNT. Sjellja e Vodafone duke bllokuar aksesin dhe interkoneksionin në qarkun E1 në mënyrë të njëanshme, është në kundërshtim me parimet e konkurrencës së ndershme të parashikuara në ligjin nr. 9121. Veprimet e Vodafone konsiderohen si antiligjore nga Neofone, pasi çojnë drejt mbylljes së tregut të terminimit për operatorët e tjerë duke shfrytëzuar pozitën FNT.
11. Neofone shpjegon se, është e detyruar të vuajë drejtpërdrejt financiarisht mbylljen e qarqeve të interkoneksionit nga Vodafone, si dhe kosto të tjera jo të drejtpërdrejta, si prishja e imazhit dhe e kontratave komerciale me operatorët jashtë Shqipërisë. Këto kosto të shkaktuara në mënyrë antiligjore nga Vodafone përbëjnë një dëm të konsiderueshëm financiar për Neofone sh.p.k.
12. Neofone i ka shprehur Vodafone, se në bazë të kuadrit rregullator dhe lirisë komerciale, Vodafone mund të operojë me çdo tarifë të pranuar nga të palët me vullnet të lirë. Vodafone duhet të provojë se këtë tarifë e ka të orientuar në kosto.
13. Neofone sh.p.k., sqaron se operatori FNT – Vodafone, ka kryer në mënyrë të njëpasnjëshme shkeljet:
 - Të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nenet: 42/c, 59;
 - Marrëveshjen e interkoneksionit mes Neofone dhe Vodafone, e datës 1.3.2011: Aneksi IV, pika 4.6.2 - Kapaciteti minimal, pika 7.1 – Tarifat e shërbimeve, pikën 18.4 – situata abuzive;
 - Kodin Civil, Pjesa IV, nenet 420, 663, 673, 681, 682, 685, 690, 693, 707.
14. Sa më sipër Neofone i kërkon AKEP:

- Në zbatim të nenit 60, 61, 120, 135, 137, etj, të zgjidhë në mënyrë sa më urgjente mosmarrëveshjen me Vodafone, me qëllim minimizimin e kostove të shkaktuara në mënyrë të padrejtë, abuzive e në kundërshtim me kuadrin rregullator;
- Të specifikojë qartë kushtet e interkoneksionit mes Neofone e Vodafone, duke parandaluar mosndryshimin e aksesit për terminimin dhe facilitetet shoqëruese, praktikë e cila po ndiqet gjerësisht nga Vodafone, duke limituar numrin e kanalave në “*facilitate*” dhe duke limituar qëllimin e përdorimit të faciliteteve duke krijuar barriera artificiale në zhdukjen e konkurrencës.
- Të urdhërojë hapjen e urgjente të aksesit në facilitetet aktuale mes Vodafone dhe Neofone dhe anulimin e ndërprerjes së njëanshme të tij për terminim si për trafik kombëtar dhe për atë ndërkombëtar për një shfrytëzim eficient të faciliteteve.
- Të dalë me një urdhër të posaçëm në pëputhje me kompetencat e dhëna nga neni 60, i ligjit nr. 9918, duke urdhëruar Vodafone të hapë aksesin në qarqet e interkoneksionit të cilat bllokuan aktualisht si dhe të vendosë tarifën e terminimit për thirrjet ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone.

III. Vodafone Albania sh.a., me shkresën me ref. LGD/0142/0X, datë 4.5.2012, (nr. 509/5Prot. i AKEP, datë 7.5.2012) “*Dërgohen shpjegimet e Vodafone Albania për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone dhe Vodafone Albania, të filluar me VKD nr. 1882, datë 19.4.2012*”, sqaron se:

- a. Vodafone, është njoftuar me shkresën nr. 509Prot, i AKEP, datë 20.4.2012, njoftohet për VKD nr. 1882, datë 19.4.2012, “*Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone dhe Vodafone Albania*”. Vodafone, deklaroi se ka vepruar në përëuthshmëri të plotë me ligjin nr. 9918, Rregulloren për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, Rregulloren për Akses dhe interkoneksion, ORI-n e Vodafone, dhe VKD nr. 1740, përgjatë gjithë veprimtarisë së tij në marrëdhënie me Neofone, dhe se ka respektuar çdo afat dhe detyrim që sanksionohet nga kjo bazë ligjore.
- b. Vodafone, për sa më lart, në kuptim të këtij ankimi administrativ, paraqet prapësimet si më poshtë:
 1. Negociatat e palëve për tarifën e shërbimit kanë qenë të plota, të rregullta dhe janë zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. AKEP me anë të VKD nr. 1740, ka rivendosur në fuqi tarifën e terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me terminimin e thirrjeve në rrjetin e Vodafone, janë objekt negociatash komerciale. Tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të vendosen nga palët në marrëveshje mbi bazën e respektimit të parimit të lirisë kontraktuale dhe të proporcionalitetit të interesave reciproke komerciale për të mos shkaktuar dëm të shpërpjestuar të interesave të tyre. Çdo pretendim i Neofone, për negociatën jo të rregullta është i pabazuar dhe në mosnjohje të ligjit.
Vodafone ka ndjekur praktikën e njohur botërisht dhe të pranuar në tregun ndërkombëtar të telekomunikacioneve – të njoftimit të cmimit. Ka njoftuar ofertën e saj të terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij me njoftim paraprak implementimi 7

ditor. Vodafone ka marrë pranim me shkrim nga operatorët e tjerë për këtë shërbim, të cilët sot, terminojnë trafik ndërkombëtar në rrjetin e Vodafone, përkundrejt tarifës së njoftuar dhe kjo është e evidentueshme sepse janë depozituar kopje të amendimeve të MI në AKEP.

2. Vodafone, nuk ka kufizuar akses në facilitet, sic edhe e ka përmendur edhe nga emaili i dt. 17.2.2012, apo shkresa e dt. 24.2.2012 me ref, LGD/0033/OX. Kapaciteti i lënë në dispozicion Neofone është konfiguruar për të plotësuar maksimalisht nevojat e tij për shërbime që ka pranuar të shfrytëzojë dhe për të cilat është rënë dakord mes palëve përparakisht. Përlllogaritja është bërë në përputhje me dispozitat e ORI dhe të parashikimeve të trafikut që Neofone ka depozituar në momentin e lidhjes së MI. Parashikimi i trafikut të Neofone, tregon se nga Prilli 2011 – Shtator 2011, trafiku kombëtar që do gjenerohej nga Neofone ishte 200 – 3000 minuta. Trafiku nga Prilli 2012 – Shtator 2012, trafiku kombëtar që do gjenerohej nga Neofone është parashikuar po njësoj 200 – 3000 minuta. (*Bashkëngjitur, kesaj shkrese Vodafone ka depozituar edhe historikun për parashikimin e trafikut të Neofone*). Vodafone sqaron se pretendimi i Neofone për kapacitet të pamjaftueshëm, është i pavërtetë, sepse kapaciteti që ka patur në dispozicion ka qenë i llogaritur sipas parashikimeve të Neofone, dhe është plotësisht në përputhje me kuadrin rregullator ekzistues.

Neofone, në komunikimet elektronike ka sqaruar se nuk ka qëllim të operojë në rrjetin “retail”, të ketë rrejt abonentesh të tij e të gjenerojë trafik, por synon tregun e shumicës apo të “Carrier” (emaili i dt. 17.2.2012). Kjo vjen në kundërshtim me RIO dhe parashikimet e “Rregullores së aksesit dhe interkoneksionit”. Në aneksin e MI, për numeracionin dhe seritë numerike, palët janë të detyruara të shkëmbejnë trafik vetëm nëpërmjet serive numerike të alokuara nga AKEP, për rrjetin e tyre dhe i janë njoftuar palës tjetër paraprakisht (aneksi V). Neofone, nuk ka nënshkruar asnjë amendim të MI, për të ligjësuar rolin e tij si Carrier. Vodafone nuk disponon asnjë dokument që e legjitimon Neofone si Carrier (Autorizim të Përgjithshëm, apo dokument të AKEP që konfirmon leshimin e ISPC, as ndonjë marrëveshje me operator ndërkombëtar). Kështu çdo pretendim i ngritur në këtë drejtim nga ana e Neofone është i pabazuar në ligj. Vodafone thekson se ndryshe nga sa pretendon Neofone, nuk është shprehur para asnjë operatori qoftë edhe alternativ, në mënyrë direkte apo indirekte për kufizim aksesit.

3. Tarifa e terminimit të trafikut ndërkombëtar nga Vodafone është bërë sipas përcaktimeve të ligjit 9918, i cili shpreh qartë se : *...tarifa është në diskrecion të palës që ofron shërbimin...*. Tarifat e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike vendosen nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike. Sic edhe operatorët, si edhe Neofone gëzojnë diskrecion të plotë për të përcaktuar cmimin e terminimit në rrjetin e tyre.

Tarifat e Vodafone për terminimin e trafikut ndërkombëtar janë konkurruese dhe të pranueshme në tregun e terminimit ndërkombëtar të përbërë nga operatorë si: Cable&Wireless, British Telecom, Ote Globe, Telecom Italia etj. Vodafone u ka komunikuar operatorëve një tarifë terminimi plotësisht të absorbueshme nga tregu. Edhe sikur të ndodhte e kundërta, faktorë determinante janë kërkesa – oferta në treg, këta rregullojnë tarifat në treg.

4. Vodafone, nuk ka vendosur në dispozicion të Neofone shërbimin e terminimit të trafikut ndërkombëtar nga data 15 shkurt 2012, pasi Neofone ka refuzuar tarifën për këtë shërbim e për rrjedhojë ka refuzuar të paguajë për këtë shërbim. Vodafone ka vepruar në përputhje të plotë me Kodin Civil, nenin 663 dhe ORI e Vodafone, Vendimin e AKEP nr. 1740, datë 20.12.2011. Për sa kohë Neofone, nuk pranon tarifën e shërbimit, shërbimi specifik nuk mund të ofrohet. Edhe pretendimi i Neofone, për të patur shërbimin e terminimit pa pranuar të paguajë tarifën është i padrejtë dhe i pabazuar në ligj.
5. Vodafone nuk ka cënuar ligjin nr. 9123, Për mbrojtjen e konkurrencës. Me njoftimin e kryer me datë 7 shkurt 2012, Vodafone ka dhënë të njëjtën tarifë terminimi të gjithë operatorëve, qofshin carriers ndërkombëtarë apo operatorë alternativë të regjistruar sipas ligjit. Kështu ka zbatuar me përpikmëri parimin e mosdiskriminimit, si OFNT. Pretendimi i Neofone, se Vodafone ka te drejtë të vendosë tarifë të ndryshme, është i pabazuar sepse cdo tarifë e diferencuar e ofruar në tregun vendas do të sillte shkelje të konkurrencës dhe deformim të tregut.
6. I bëjmë me dije Neofone, për pretendimin se Vodafone është në shkelje të përsëritur, se po cënon integritetin e kompanisë Vodafone, e cila operon prej shumë vitesh në tregun shqiptar dhe ka reputacion të shkëlqyer. Për çdo shkelje të pretenduar vendosin organet e autorizuar për të cilesuar një gje të tillë, si gjykatat apo AKEP.
7. Sa i takon kërkesës së Neofone për ri – rregullim tarife për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare, duke i treguar AKEP si të kryejë detyrën e tij, Vodafone shprehet se kjo përveç se është sjellje arrogante, nuk është objekt i kësaj mosmarrëveshjeje. Këto pretendime të Neofone kanë të bëjnë me VKD 1740 e duhet të ngriheshin me ankim të veçantë e jo në objektin e kësaj mosmarrëveshjeje.
8. Çdo pretendim i Neofone në lidhje me dëme të tjera të shkaktuara është plotësisht i pabazuar në ligj e në marrëveshjen mes palëve dhe si i tillë nuk duhet marrë në shqyrtim nga AKEP. Duke qenë se veprimet e Vodafone kanë qenë të bazuara në ligj dhe në kuadrin rregullator, nuk i ka shkaktuar asnjë dëm Neofone sic pretendon në kërkesat e tij.
9. Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i procedurave administrative në R.SH.”, nenet 99 e në vijim, dhe Rregulloren për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nenet 5, 6 dhe 7, Vodafone kërkon:
 Rrëzimin e ankimit administrativ dhe mbylljen e procedimit administrativ të Neofone.

IV. AKEP pasi ka shqyrtuar pretendimet e paleve vëren dhe vlerëson se,

1. Sipas pikës 1.a) të nenit 13 të ligjit nr. 9918, ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet kundrejt autorizimit nga

AKEP-i, me përjashtim të rasteve kur rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike:

a) nuk kanë qëllime fitimi (tregtimi) dhe kur nuk janë të disponueshme për publikun.

Në zbatim të këtij kushti ligjor dhe kompetencës së parashikuar në shkronjën p) të nenit 8 të po këtij ligji, AKEP-i në Rregullore Nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD nr. 1774, datë 02. 02. 2012, në procedurën e aplikimit të regjistrimit të njoftimit përcakton se kur një sipërmarrës dëshiron të ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, ai autorizohet nga AKEP nëpërmjet lëshimit të Çertifikatës së Konfirmimit të Njoftimit, pasi të ketë plotësuar kushtet:

- të jetë një operator aktiv që ofron rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike;
- të jetë pajisur nga AKEP-i me ISPC sipas rregullave të përcaktuara në Aktin Nr. 17, datë 16. 04. 2010 “Rregulla për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”.

Gjithashtu sipas nenit 13 të Rregullores nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, përcaktohet se: *“Të gjitha konfirmimet e njoftimit të lëshuara sipas rregullores Nr. 3, datë 19. 09. 2008, mbeten në fuqi dhe veprojnë deri në çastin e ndryshimit të tyre në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore por jo më vonë se 3 muaj nga data e miratimit të saj”*. Kjo do të thotë që brenda këtij afati ligjor (deri më datë 08.05. 2012), të gjithë sipërmarrësit e interesuar duhet të aplikojnë dhe të pajisen me Çertifikatën e Njoftimit të Konfirmimit sipas Rregullores së re Nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”. Pas këtij afati, asnjë sipërmarrës nuk është i autorizuar të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike nëse nuk është pajisur më parë nga AKEP-i me Çertifikatën e Regjistrimit të Njoftimit për ofrimin e tyre.

Sipas këtyre kushteve ligjore dhe rregullatore, ankimesi nuk mund të ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, pasi në përfundim të afatit tranzitor sipas nenit 13 të Rregullores nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm” deri në datën e shqyrtimit të kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas këtij vendimi, nuk është i autorizuar ta ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, sepse gjendet në kushtet e mosplotësimit të kushteve sipas Aktit Nr. 17, datë 16. 04. 2010 “Rregulla për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”.

2. Për sa i përket periudhës nga data e pranimit të kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe fillimit të procedimit administrativ sipas VKD nr. 1882, datë 19.04.2012 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.”, bazuar në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga palët duke iu referuar bazës ligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi në atë periudhë, mosmarrëveshja duhet të çmohet duke marrë në konsideratë se AKEP me VKD nr.1740 datë 20.12.2011, ka vendosur që tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranziturara të jetë jashtë rregullimit duke filluar nga data 1.02.2012. Njëkohësisht AKEP me VKD nr.1886, datë 19.04.2012 ka miratuar edhe shtesat dhe ndryshimet përkatëse të RIO së Vodafone Albania, ku janë materializuar vendimet e AKEP-

it për këtë çështje. Në këto kushte palët për nivelin e tarifës (çmimin) për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara duhet të bien dakort midis tyre mbi bazën e negociatave në kushtet e lirisë kontraktuale për vendosjen e një çmimi në përputhje me interesat reciproke komerciale. Sipas këti kushti sipërmarrësi Vodafone Albania ka lidhur marrëveshjet e interkoneksionit dhe me sipërmarrësit e tjerë të interesuar. Duke iu referuar fakteve të paraqitura nuk rezulton që Vodafone Albania të mos ia ketë ofruar Neofon-it të njëjtën tarifë që ka lidhur edhe me sipërmarrësit e tjerë për këtë shërbim. Ka qenë Neofone Albania ajo që nuk e ka pranuar këtë tarifë të Vodafone Albanias, duke mos marrë në konsideratë faktin që tashmë kjo tarifë është jashtë rregullimit nga AKEP-i.

3. Pretendimet e Neofone për interkonektimin me Vodafone kanë lidhje me shërbimin e Neofone të tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare për terminim në rrjetin Vodafone dhe jo për shërbimin publik telefonik fiks të ofruar pajtimtarëve të rrjetit publik fiks Neofone. Neofone ka deklaruar se nuk ka pajtimtarë telefonik fiks për 2010 dhe 2011, duke ofruar vetëm tranzitim thirrjesh.

4. Nga sa faktohet më sipër, në interpretim të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 9918, duke qenë se Neofone sh.p.k., në momentin e shqyrtimit të këtij vendimi nuk është i autorizuar nga AKEP-i sipas legjislacionit dhe kuadrit rregullator në fuqi për ofrimin e shërbimit të tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, për rrjedhojë nuk gjendet në rrethanat e plotësimit të kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 9918 për vendosjen ndaj Vodafone Albania të detyrimit me anë të një Urdhëri për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e terminimit në rrjetin e Vodafone Albania të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara prej tij.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimin administrativ të filluar me Vendimin Nr.1882, datë 19.04.2012 “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.”.

2. Të mos pranojë kërkesën e Neofone sh.p.k., për nxjerrjen e një Urdhëri për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.a., për shërbimin e terminimit në rrjetin e Vodafone Albania të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara prej tij.

3. Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.për mbylljen e procedimit administrativ;

4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**